

KRONIKË E ZEZË

Arrestohet burri që kishte rrëmbyer një tjetër para një jave



Foto: PK

Policia e Kosovës, ka arrestuar një të dyshuar dje, pasi ai më 13 shtator kishte rrëmbyer një burrë.

“Pas raportimit të rastit dhe ndërmarrjes së masave operativohetimore nga Policia e Kosovës, konkretisht hetimet rajonale të Prishtinës, me datë 19.09.2020, është arrestuar i dyshuari mashkull kosovar, pasi që i njëjti ditë më parë kishte rrëmbyer dhe grabitur viktimën mashkull Kosovar”, thuhet në njoftimin 24 orësh të PK-së.

Gjatë kontrollit, Policia ka gjetur dhe i ka konfiskuar një pistoletë, një pushkë ajrore, një elektro-shok dhe tre DVR.

I dyshuari është dërguar në mbajtje me vendim të prokurorit.

© KOHA. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

20 shtator 2020, 08:29

Shpërndaje në



Like 8

Share

#POLICIA E KOSOVES

#RREMBIM

TË NGJASHME



Shërbimi Korrektues i Kosovës kërkon rruga të barabarta me policët



Kthehet mbrapsht autobusi me serbë që synonte veriun për të protestuar



Nesër varroset polici Izet Demaj